

1.3.1	Iceland moss herb
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

FLETUDHËZIM: INFORMATA PËR PËRDORUESIN

Herbion® shurup i myshkut të islandës ekstrakt i butë i myshkut të islandës për qetësimin e kollës

Lexojeni këtë fletudhëzim të tërin me kujdes sepse përmban informata të rëndësishme për ju.

Ky bar është në dispozicion pa recetë. Megjithatë, ju duhet të merrni Herbion shurup i myshkut të islandës me kujdes për të përfutur rezultatet më të mira prej tij.

- Ruajeni këtë fletudhëzim. Mund t'ju duhet ta lexoni përsëri.
- Nëse keni pyetje ose kërkoni këshilla të tjera, drejtojuni farmacistit.
- Duhet t'a kontaktoni mjekun nëse simptomat ju përkeqësohen ose nuk përmirësohen pas 7 ditësh.
- Nëse cilido nga efektet anësore përkeqësohet, ose nëse vëreni ndonjë efekt anësor që nuk figuron në këtë fletudhëzim, ju lutemi tregojini mjekut ose farmacistit.

Në këtë fletudhëzim:

1. Çka është Herbion shurup i myshkut të islandës dhe për se përdoret
2. Para se të merrni Herbion shurup i myshkut të islandës
3. Si të merrni Herbion shurup i myshkut të islandës
4. Efektet e mundshme anësore
5. Si ta ruani Herbion shurup i myshkut të islandës
6. Informata shtesë

1. ÇKA ËSHTË HERBION SHURUP I MYSHKUT TË ISLANDËS DHE PËR SE PËRDORET

Herbion shurup i myshkut të islandës përmban ekstrakt të butë të myshkut të islandës. Herbion shurup i myshkut të islandës është bar bimor tradicional që rekomandohet për:

- kollë të thatë, irrituese,
- të ngjirurit e zërit dhe dhimbje të fytit.

Ekstrakti i myshkut të islandës përmban sasi të lartë të mucilageve të tretshme në ujë, për të cilat supozohet se mbulojnë, mbrojnë dhe njomin membranën e mukozës së gojës dhe të fytit, duke lehtësuar kollën e thatë dhe irrituese.

Herbion shurup i myshkut të islandës është bar bimor tradicional i cili përdoret për indikacionet e dhëna kryesisht të bazuara në përdorim afatgjatë.

Duhet të kontaktoni mjekun nëse simptomat tuaja përkeqësohen ose nuk përmirësohen pas 7 ditëve.

2. PARA SE TË MERRNI HERBION SHURUP I MYSHKUT TË ISLANDËS

Mos merrni Herbion shurup i myshkut të islandës

- nëse jeni alergjik në ekstrakt të myshkut të islandës ose ndaj ndonjë prej përbërësve të këtij bari (listuar në seksionin 6).

Tregoni kujdes të veçantë me Herbion shurup i myshkut të islandës

Bisedoni me mjekun tuaj ose farmacistin para se të merrni Herbion shurup i myshkut të islandës.

- Nëse keni probleme me rrugët e frymëmarrjes për shkak të vështirësive me frymëmarrjen, ethe, kollitje kronike ose sputum me gjakderdhje, menjëherë duhet të kontaktoni mjekun;
- Nëse gjendja nuk përmirësohet pas 7 ditëve të marrjes së barit, ju duhet të vizitoni mjekun tuaj.

1.3.1	Iceland moss herb
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

Fëmijët dhe adoleshentët

Herbion shurup i myshkut të islandës është i indikuar për përdorim te adoleshentët dhe fëmijët më të moshuar se një vjet.

Fëmijëve të moshës prej 1-4 vjet ky bar duhet ti jipet vetëm pas ekzaminimit të mjekut dhe sipas këshillës së mjekut.

Marrja e barnave tjera

Ju lutem tregojini mjekut ose farmacistit tuaj nëse jeni duke marrë ose keni marrë barna të tjera kohëve të fundit, duke përfshirë barna që merren pa recetën e mjekut.

Nuk ka të dhëna se Herbion shurupi i myshkut të islandës ndikon në efektin e barnave tjera.

Marrja e Herbion shurup i myshkut të islandës me ushqim dhe pije

Rekomandohet për të pirë shumë çaj ose pije tjera të ngrohta, gjatë marrjes së Herbion shurupit të myshkut të islandës, por jo menjëherë pas marrjes së barit, sepse marrja e barit shumë shpejtë mund të hiqet nga mukoza e gojës dhe fytit.

Shtatzënia dhe gjdhënia

Kërkojini këshillë mjekut ose farmacistit para përdorimit të barnave.

Nëse jeni shtatzënë ose ushqeni fëmijën me gji, mendoni se jeni shtatzënë ose planifikoni të keni bebe, pyetni mjekun tuaj ose farmacistin për këshillë, para se të merrni këtë bar.

Meqë nuk ka të dhëna të mjaftueshme mbi sigurinë e përdorimit të ekstraktit të myshkut të islandës gjatë shtatzënisë dhe ushqyerjes me gji, nuk rekomandohet përdorimi i Herbion shurupit të myshkut të islandës gjatë shtatzënisë dhe ushqyerjes me gji.

Ngasja dhe përdorimi i makinerive

Nuk ka të dhëna se bari ndikon në aftësinë për të drejtuar automjete ose për të përdorur makineri.

Informata të rëndësishme për disa nga përbërësit e Herbion shurup i myshkut të islandës Herbion shurup i myshkut të islandës përmban sorbitol (E420), benzoat natriumi (E211), etanol dhe natrium (nga benzoat natriumi)

5 ml shurup (1 lugë matëse) përmban 2660 mg sorbitol, 10 mg benzoat natriumi dhe 3 mg etanol (një përbërës i aromës të limonit).

Sorbitoli është burim i fruktozës. Nëse mjeku juaj ju ka thënë se ju (ose fëmija juaj) keni intolerancë ndaj disa sheqernave ose nëse jeni diagnostikuar me intolerancë trashëgimore ndaj fruktozës (HFI), një çrregullim gjenetik i rrallë në të cilin personi nuk mund ta shpërbëjë fruktozën, bisedoni me mjekun tuaj para se ju (ose fëmija juaj) ta merrni apo pranoni këtë bar. Sorbitoli (≥ 140 mg/kg/ditë) mund të shkaktojë shqetësim gastrointestinal dhe efekt laksativ të lehtë.

Sasia e alkoolit në dozën maksimale ditore (60 ml shurup) është e barabartë me më pak se 0,9 ml birrë ose 0,36 ml verë. Sasia e vogël e alkoolit në këtë bar nuk do të ketë ndonjë efekt të vërejtshëm.

Ky bar përmban më pak se 1 mmol natrium (23 mg) në 5 ml (1 lugë matëse), çfarë do të thotë se në esencë është "pa natrium".

3. SI TË MERRET HERBION SHURUP I MYSHKUT TË ISLANDËS

Gjithmonë merrni Herbion shurup i myshkut të islandës saktësisht siç ju ka udhëzuar mjeku. Duhet të konsultoheni me mjekun ose farmacistin nëse nuk jeni të sigurt. Doza e zakonshme është:

Doza e zakonshme për **të rriturit dhe adoleshentët e moshës mbi 16 vjeç** është 15 ml shurup 4 herë në ditë.

Doza e zakonshme për **fëmijët e moshës 10 deri në 16 vjeç** është 10 ml shurup 4 herë në ditë.

1.3.1	Iceland moss herb
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

Doza e zakonshme për **fëmijët e moshës 4 deri në 10 vjeç** është 5 ml shurup 4 herë në ditë.

Doza e zakonshme për **fëmijët e moshës 1 deri në 4 vjeç** është 2,5 ml shurup 4 herë në ditë.

Fëmijëve të moshës prej 1-4 vjet këtë bar duhet dhënë vetëm pas ekzaminimit të mjekut dhe sipas këshillës së mjekut. Herbion shurupin e myshkut të islandës fëmijëve mund t'ia japin vetëm prindërit ose kujdestarët e rritur.

Herbion shurup i myshkut të islandës nuk është i dedikuar për përdorim te fëmijët më të vegjël se një vjet.

Mos hani apo pini menjëherë pas marrjes së Herbion shurupit i myshkut të islandës, sepse bari mund të largohet nga membarana e mukozës së gojës dhe fytit shumë shpejt.

Kohëzgjatja e trajtimit varet nga natyra dhe ashpërsia e sëmundjes dhe trajtimi mund të vazhdojë për një periudhë më të gjatë (7-14 ditë). Ju duhet të merrni barin edhe për disa ditë pasi simptomat e sëmundjes janë zhdukur.

Tundeni shishen para përdorimit.

Nëse merrni Herbion shurup i myshkut të islandës më shumë se ç'duhet

Mos merrni doza më të larta se ato që ju janë përshkruar. Nuk është raportuar asnjë rast i mbidozimit.

Nëse harroni të merrni Herbion shurup i myshkut të islandës

Mos merrni dozë të dyfishtë për ta kompensuar dozën e harruar.

Nëse e ndërprisni marrjen e Herbion shurup i myshkut të islandës

Në rast se keni pyetje të mëtejme lidhur me përdorimin e këtij produkti, drejtohuni mjekut ose farmacistit.

4. EFEKTET ANËSORE TË MUNDSHME

Sikurse të gjitha barnat, Herbion shurup i myshkut të islandës mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo te të gjithë paraqiten ato.

Të panjohura (frekuenca nuk mund të vlerësohet në bazë të të dhënave të disponueshme):

- reaksion alergjik që manifestohet si skuqje, kruarje të lëkurës dhe vështirësi në frymëmarrje.

Nëse ndodh një reaksion alergjik, ndërpreni marrjen e barit dhe kontaktoni mjekun tuaj.

Paraqitja e efekteve anësore

Nëse ju paraqitet çfarëdo efekti anësor, duhet që të lajmëroni mjekun ose farmacistin. Kjo përfshin çdo efekt anësor që nuk është dhënë në këtë fletudhëzim. Efektet anësore mund të paraqiten drejtëpërsëdrejti nëpërmjet sistemit nacional të raportimit. Me paraqitjen e efekteve anësore mund të ndihmoni në vlerësimin e sigurisë së këtij bari.

Nëse ndonjë efekt anësor përkeqësohet, ose nëse vëreni ndonjë efekt anësor që nuk figuron në këtë fletudhëzim, ju lutemi njoftojeni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TË RUHET HERBION SHURUP I MYSHKUT TË ISLANDËS

Mbajeni larg syve dhe duarve të fëmijëve.

1.3.1	Iceland moss herb
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

Mos e përdorni Herbion shurup i myshkut të islandës pas datës së skadimit e cila është e shënuar në karton pas EXP. Data e skadimit i referohet ditës së fundit të atij muaji.

Mos e mbani në frigorifer.

Shurupi duhet të përdoret brenda 3 muajve pas hapjes së shishes.

Barnat nuk duhet të hidhen nëpërmjet kanalizimit ose mbeturinave të shtëpisë. Pyeteni farmacistin se si t'i hidhni barnat që nuk ju duhen më. Këto masa do të ndihmojnë për ta ruajtur mjedisin.

6. INFORMATA SHITESË

Çka përmban Herbion shurup i myshkut të islandës

- Substancat aktive është: ekstrakt i butë i myshkut të islandës. 1 ml shurup përmban 6 mg ekstrakt të butë të myshkut të islandës (*Cetraria islandica* (L.) Acharius s.l., *thallus*), që është ekuivalent me 96 - 108 mg të myshkut të islandës.
Tretësi ekstraktues: ujë i destiluar.
- Përbërësit e tjerë janë: sorbitol i lëngët (jo kristalizues) (E420), gomë ksantani (E415), benzoat natriumi (E211), acid citrik monohidrat (E330) dhe aromë limoni (etanol).
Shih seksionin 2 "Herbion shurup i myshkut të islandës përmban sorbitol (E420), benzoat natriumi (E211), etanol dhe natrium (nga benzoat natriumi)".

Si duket Herbion shurup i myshkut të islandës dhe përbërja e paketimit

Shurupi është me ngjyrë të verdhë-kafe në ngjyrë kafe, në formë të lëngshme opaleshent i lehtë. Mund të vërehet një sediment i lehtë tipik i substancave natyrore.

Shurupi është në dispozicion në kuti me 150 ml shurup në një shishe, së bashku me një lugë matëse.

Mënyra e dhënies së barit

Bari jepet pa recetë të mjekut.

Mbajtësi i Autorizimit për Marketing dhe Prodhuesi

KRKA, d.d., Novo mesto, Šmarješka cesta 6, 8501 Novo mesto, Slloveni

tel: +386 7 331 28 84,

fax: +386 7 332 27 42

www.krka.si

Ky fletudhëzim së fundmi është miratuar në

05/2024.